# DËSHMI ARKIVI

**A-476718**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | I akuzuar për krime të lidhura me gjenocidin në Ruandë, 100 mijë paund garanci për të… \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/i-akuzuar-per-krime-te-lidhura-me-gjenocidin-ne-ruande-100-mije-paund-garanci-per-te/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 14:50:41 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 14:45:41 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7cc3a063be532febdb7221f51862fd15d75d9f1df4f09f739f6a0f0171fb9f2d` |
| TEKSTI | `e1a3139649847f220a8548bffe31ee985648d169fb37a70afeb0cc33e9710299` |
| PAMJA | `2f29fd95122b3fc0c7fa1e06bf714c3961e53bf90d13e9e52d7cb5b47463c596` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `51d2e3c3aba7d30d0e79e8b96bd356f8ee6a11ce88e5cd8814681faa5bcc5a2c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `70759019bbbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/51d2e3c3aba7d30d0e79e8b96bd356f8ee6a11ce88e5cd8814681faa5bcc5a2c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Bota

# I akuzuar për krime të lidhura me gjenocidin në Ruandë, 100 mijë paund garanci për të…

*Eriselda Doko*

28 Shtator 2026




Gjykata Old Bailey në Londër ka vendosur një garanci prej 100 mijë paundësh për Dr. Vincent Brown, i akuzuar për vepra penale të lidhura me gjenocidin e vitit 1994 në Ruandë. Brown do të qëndrojë në paraburgim nëse kushti financiar nuk plotësohet.

Vendimi u mor nga gjyqtari Mark Lucraft KC, i cili vendosi gjithashtu një sërë kushtesh të tjera për lirimin me kusht. Brown duhet të dorëzojë pasaportën dhe çdo dokument identifikimi kombëtar, të mos aplikojë për dokumente të reja udhëtimi ndërkombëtar, t'i nënshtrohet një ore policore në adresën e tij në Londër, të monitorohet elektronikisht dhe të paraqitet çdo ditë në polici.

Brown, 65 vjeç, më parë i njohur si Dr. Vincent Bajinya, akuzohet se ka vrarë, drejtuar ose inkurajuar vrasjen e pjesëtarëve të komunitetit Tutsi gjatë gjenocidit në Ruandë. Sipas akuzave, ai dyshohet se kishte një rol si "udhëheqës" ose "mbikëqyrës" të akteve të dhunshme të kryera nga persona të tjerë. Ai i mohon akuzat.

Sipas çështjes së ngritur nga autoritetet britanike, gjashtë persona dyshohet se u vranë mes 6 dhe 13 prillit, përfshirë tre anëtarë të së njëjtës familje, një shofer taksie, si dhe një nënë dhe djalin e saj të vogël. Viktimat e identifikuara janë Dominique Mukurarinda, Immaculee Mukankusi, Gerasi Rurangirwa, Leandre Mbogoye, Charlotte Kamaguja dhe Olivier Tuyishime.

Brown u akuzua pas një hetimi shtatëvjeçar britanik mbi vrasjet. Sipas autoriteteve, ai është personi i parë në Mbretërinë e Bashkuar që përballet me akuzë për gjenocid në lidhje me ngjarjet e Ruandës.

Garancia e vendosur nga gjyqtari është rritur ndjeshëm krahasuar me shumën prej 25 mijë paundësh të caktuar më herët nga gjykata e magjistratëve.

Brown është mjek i kualifikuar në Ruandë që nga vitet 1980. Ai më vonë drejtoi Departamentin e Shëndetit Familjar në Kigali. Në vitin 2006 punoi në organizatën bamirëse me bazë në Londër, Praxis, e cila ofron mbështetje për refugjatët, ndërsa ka shërbyer edhe në Task Forcën e Informierëve për Refugjatët

Infermiereve për Refugjatët.

Gjenocidi në Ruandë ndodhi në vitin 1994 dhe zgjati rreth 100 ditë. Gjatë kësaj periudhe u vranë rreth 800 mijë persona, kryesisht pjesëtarë të komunitetit Tutsi dhe Hutu politikisht të moderuar.

Brown pritet të paraqitet sërish në Old Bailey më 9 tetor. Ndërkohë, hetimet britanike për vepra të tjera të dyshuara penale të lidhura me gjenocidin në Ruandë vijojnë.

## LAJME TË NGJASHME



Foto/ Humbi jetën tragjikisht gjatë pushimeve, varka ku ndodhej 16-vjeçarja britanike u përfshi nga flakët...

2 MIN



Rreth 41% e njerëzve që panë paralajmërimet për nxehtësinë në Mbretërinë e Bashkuar nuk morën asnjë veprim!

2.5 MIN



Duke menduar jashtë kutisë për mirëqenien/ Brenda Festivalit të Mjekësisë në Mbretërinë e Bashkuar!

2.5 MIN




'Spiunonin për llogari të Kinës', tre të arrestuar në Britaninë e Madhe

1.5 MIN



Proda dhe drejtuesi britanik për krimin e organizuar: Të vendosur për thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar!

1.5 MIN

## MË TË LEXUARAT



Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual!



Vjeshta kalohet më bukur me muzikën e përzgjedhur nga DeeJay-t e TAR!



"Patëm një dasmë të madhe shqiptare…"/ Dua Lipa ndan pamje nga dasma familjare!



Ben Affleck pranon se fëmijët qeshin me të kur përpiqet t'u japë këshilla për dashurinë?



Rita Ora tërheq vëmendjen me paraqitjen e fundit, vë në pah linjat trupore!



Vdekja e Giorgos Mazonakis,



"Para nga qielli"/Parashikimi i



Nga dhoma e hotelit me



"Villa Sol Lumière", një oaz



Aksident në Fushë-

zbulohet mesazhi i fundit për trajtimin dhe pagesën…

Baba Vanga-s për dy shenjat e zodiakut!

Guardiolën te 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura te Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe!

paqeje larg kaosit të qytetit!

Krujë/Përplasen 3 automjete, humb jetën një 19-vjeçar!

## EDITORI SUGJERON



7 ushqime që mund t'i përkeqësojnë efektet anësore nëse jeni duke marrë Ozempic!



"Villa Sol Lumière", një oaz paqeje larg kaosit të qytetit!




Molla apo dardha?! Ja se cili frut është më i shëndetshëm...



Vjeshta kalohet më bukur me muzikën e përzgjedhur nga DeeJay-t e TAR!



Këshilli i Sigurisë Kombëtare mblidhet urgjentisht pas rastit të Vlora Hysenit, Muhamed Veliu jep detajet: Kush do të jetë në krye të SHISH?



Apple surprizon me risitë, AI bën gabimin e frikshëm dhe Tesla rikthen makinën që "fluturon"!



As viti i shtatë dhe as i dhjetë, ja se kur tradhtojnë çiftet në një lidhje…



Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla Roadster rikthehet me një premtim të çmendur: Makina që mund të fluturojë?!



Një identifikim i gabuar nga AI ngriti në këmbë ushtrinë e SHBA-së, gati për sulm! Ja si ndodhi gjithçka…




Apple Watch tani "dëgjon" bisedat tuaja dhe i përmbledh për ju?! Risia që po ngre pikëpyetje...

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

**LINKS**

- Kontaktoni
- Marketing
- Frekuencat
- Aksesueshmëria
- Mundësi Punësimi
- Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.